



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim A-B dhe B-A

Ngarkesa: 10 kredite, 100 orë mësimore në klasë, 15 leksione dhe 85 seminare
Viti akademik: 2024-2025, Viti i II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Master i shkencave ” Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim”
Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

T’u japë studentëve njohuri të thelluara teorike dhe praktike mbi format kryesore të interpretimit të konferencës: simultan, konsektiv dhe me fletë. Të aftësojë studentët për të përballuar situata reale interpretimi në fusha të ndryshme si politika, ekonomia, mjekësia, drejtësia, etj. Të përgatisë studentët për kalimin drejt praktikës profesionale të interpretimit, duke ndërtuar vetëbesim dhe etikë profesionale.

Objektivat specifike lëndore:

1. T’i pajisë studentët me teknika të avancuara për mbajtjen e shënimeve, përpunimin logjik të mesazhit, riformulimin dhe parashikimin gjatë interpretimit.
2. T’i aftësojë studentët për të interpretuar në mënyrë të rrjedhshme dhe të saktë përmes simulimeve në laborator me materiale autentike nga konferenca të ndryshme.
3. Të nxisë reflektimin kritik mbi performancën personale dhe të kolegëve, duke integruar parimet e kodit të etikës së profesionit.

Rezultatet e pritshme :

1. Studentët do të jenë në gjendje të interpretojnë në mënyrë të saktë dhe të qartë mesazhet nga një gjuhë burimore në një gjuhë të synuar në situata të ndryshme komunikimi institucional.
2. Do të zotërojnë teknikat kyçe të interpretimit profesional (shënime efektive, analizë logjike, riformulim, menaxhim kohe, kontroll emocional).
3. Do të jenë në gjendje të vlerësojnë dhe përmirësojnë performancën e tyre, duke respektuar parimet etike të profesionit të interpretit dhe duke reaguar në mënyrë të pavarur në situata stresuese